

V E N D I M
Nr. 315, datë 4.7.2002

**PËR NJË TRAJTIM TË VEÇANTË TË SHEFIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË
FORCAVE TË ARMATOSURA PAS LIRIMIT NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4 të nenit 30 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të pikës 4 të nenit 4 të ligjit nr.7508, datë 7.8.1991 "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të nenit 7 të ligjit nr.8847, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002" dhe të shkronjës "a" të pikës 2 të nenit 112 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 "Kodi i procedurave administrative", me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Marrja dhe dorëzimi i detyrës së Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bëhet me ceremoni ushtarake, sipas rregullores së ceremonialit ushtarak.

2. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm, pas largimit nga detyra, përfiton ruajtjen e afërt fizike, me shoqërues personal, deri në 1 (një) vit.

Ministria e Mbrojtjes merr përsipër caktimin e shoferit, të makinës dhe riparimin e saj, si dhe kuotën limit të furnizimit me karburant.

3. Kur paraqiten rrethana që rrezikojnë jetën e tij dhe të familjes, i sigurohet ruajtja e banesës, për aq kohë sa ekziston ky rrezik.

4. Efektivi që merret me ruajtjen dhe sigurimin e ish-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është pjesë e efektivit të regjimentit të Policisë Ushtarake.

5. Në rastet e lirimit nga detyra sipas shkronjave "a", "b" dhe "ç" të pikës 3 të nenit 30 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", përfiton pagesë kalimtare (nga data e ndërprerjes së marrëdhënieve financiare) në masën 60 për qind të pagës referuese për funksion (gradë), për aq kohë sa ka vjetërsi në detyrë, si Shef Shtabi, por jo më shumë se 3(tre) vjet.

6. Në rast sëmundjeje, brenda vitit të parë të lirimit nga detyra, trajtimi financiar për kurim, në ose jashtë vendit, përballohet në masën 100 për qind nga fondet e Ministrisë së Mbrojtjes.

7. Të drejtat e përcaktuara në këtë vendim përfitohen kur kohëzgjatja e qëndrimit në detyrë është jo më pak se një vit.

8. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi planifikohen dhe përballohen nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko